fondiBESA



RAPORT VJETOR
ANNUAL REPORT

2011



"Kam parë fuqinë e mikrofinancës në të gjithë botën në sytë e nënave dhe baballarëve. Është i padyshimtë-gëzimi dhe kënaqësia e thellë që ata ndjejnë nga të qenit në gjendje të punojë dhe të sigurojnë çka u nevojitet për fëmijët dhe të ardhmen e tyre. "

"I've seen the power of microfinance all over the world in the eyes of mothers and fathers. It's unmistakable—the joy and deep satisfaction they feel from being able to work hard and provide for their children and their future."

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR SHQIPËRINË

POZICIONIMI:
Në juglindje të Evropës, në anë të detit Adriatik dhe detit Jon, midis Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë e Jugosllavisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

SIPËRFAQE:

Totale:	28,748 km2
Tokë:	27,398 km2
Ujë:	1,350 km2

• Rritja ekonomike 2011:	3.1%.
• Inflacioni mesatar vjetor 2011:	3.5 %
• Përqindja e papunësisë 2011:	13.29%
• PBB vjetore 2011 (parashikim):	13 Miliardë US$
• PBB/frymë 2011 (parashikim):	4,560 US$

GENERAL INFORMATION ABOUT ALBANIA

LOCATION:
Southeastern Europe, bordering the Adriatic Sea and Ionian Sea, between Greece, Republic of Macedonia and Yugoslavia, Kosovo and Montenegro.

AREA:

Total:	*28,748 km2*
Land:	*27,398 km2*
Water:	*1,350 km2*

• *The economic growth during 2011:*	*3.1%.*
• *Average Annual Inflation 2011:*	*3.5%.*
• *The unemployment rate in year 2011:*	*13.29%*
• *The Annual GDP in year 2011 (est.):*	*13 billion US$*
• *GDP per capita in 2011 (est.):*	*4,560 US$*

Përmbajtja | Content

Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv
Message from the Executive Director 4

Arritjet 2011
Achievements 2011 6

Shtrirja gjeografike e Aktivitetit të Fondit Besa sh.a
Geographical Extension of Besa Fund j.s.c Activity 9

Bilanci
Balance sheet 10

Pasqyra e të ardhurave
Income statement 11

Pasqyra e flukseve të parasë
Cash flow statement 12

Raporti i auditorëve të pavarur
Indipendent auditor's report 14

Burimet njerëzore
Human resources 16

Struktura Organizative
Organization chart 17

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2011
Albanian economy during 2011 18

Sfidat për të ardhmen
Challenges for the future 20

Klientët
Clients 22

Partnerët
Partners 23

MISIONI

Fondi Besa sh.a ka si mision të veprimtarisë së tij të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit duke nxitur sektorin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe gjysmë urbane, nëpërmjet mbështetjes së tyre me kredi.

Klientët e Fondit Besa sh.a. përfshijnë njerëz nga të gjitha shtresat social-ekonomike, përfshirë të papunët dhe bizneset e sapokrijuara.

MISSION

Besa Fund j.s.c mission is to contribute in the country economic growth in the urban and semi urban areas, by promoting and financing the small and medium enterprises sector in Albania.

Clients of Besa Fund j.s.c are people from all socio-economic layers, including unemployed and start up businesses.

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

1994: Projekti i Mikrokredisë Urbane (projekt i Bankës Botërore).

1999: Krijimi i Fondit Besa, me themelues Fondacionin "SOROS" .

2008: Licensimi i Fondit Besa nga Banka e Shqipërisë si Institucion Financiar Jo-Bankë.

2009: Aktiviteti i Fondit Besa u transferua tek Fondi Besa sh.a.

INSTITUTIONAL DEVELOPMENT

1994: *Urban Microcredit Project (World Bank Project)*

1999: *Establishment of Besa Fund, with "SOROS" Foundation as a Founder.*

2008: *Besa Fund obtained the license from Bank of Albania to operate as a Non-Bank Financial Institution.*

2009: *Activity of Besa Fund was transferred to Besa Fund j.s.c*

Mesazh nga Drejtori Ekzekutiv
Prof. Asoc. Dr. Bajram Mucaj

Kapitali aksionar arriti vlerën prej 833 milion lekë. Gjatë vitit 2011 u disbursuan 11,420 kredi me një vlerë totale prej 3,370,280,529 lekë.

Numri i klientëve aktivë në fund të vitit 2011 arriti në 19,231 klientë, me portofol kredie prej 4,459,452,893 lekë dhe me PAR 3.37%

Të dashur miq,
Viti 2011 u karakterizua si një vit i vështirë për institucionet financiare. Megjithë vështirësitë që u krijuan nga kriza financiare botërore, Fondi Besa arriti të realizojë dhe tejkalojë objektivat financiare të planifikuara.
Kapitali aksionar arriti vlerën prej 833 milion lekë. Gjatë vitit 2011 u disbursuan 11,420 kredi me një vlerë totale prej 3,370,280,529 lekë.

Konsolidimi si dhe zgjerimi i aktivitetit në vazhdimësi, ka qenë një nga sfidat e Fondit Besa sh.a për vitin që sapo lamë. Kështu, ne punësuam 83 punonjës dhe hapëm 4 zyra të reja, duke u bërë gjithnjë e më shumë prezent në kredidhënie në zonat urbane dhe gjysmë urbane në Shqipëri. Si rezultat i zgjerimit të aktivitetit, numri i klientëve aktivë në fund të vitit 2011 arriti në 19,231 klientë, me një portofol kredie prej 4,459,452,893 lekë dhe me PAR 3.37%

Bazuar në arritjet dhe performancën e lartë, në Korrik 2011, Fondi Besa sh.a është nderuar me çmimin special HARKU I EUROPES PER CILESINE DHE TEKNOLOGJINE NE KATEGORINE E ARTE, për kontributin e pamasë në botën e biznesit, për nivel të lartë dhe profesionalizëm të demonstruar nga një performancë prestigjioze.

Dua të theksoj pa mëdyshje që çelësi i suksesit të Fondit Besa sh.a ka qenë dhe mbetet transparenca, integriteti, korrektësia, komunikimi i hapur dhe profesionalizmi i stafit tonë në punë si dhe bashkëpunimi i shkëlqyer me donatorët të cilët na kanë mbështetur në arritjen e objektivave tona.

Ashtu si dhe në të kaluarën, Fondi Besa sh.a do luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen financiare të sipërmarrjes së vogël dhe të mesme private në Shqipëri, në rritjen e vetëpunësimit, duke qenë një faktor i qenësishëm në zbutjen e varfërisë në Shqipëri.
Në mbyllje, gjej mundësinë që të falenderoj të gjithë stafin kontribues të Fondit Besa sh.a, si dhe të gjithë ata aktorë të cilët kanë ndikuar dhe mbështetur në zhvillimin institucional të Fondit Besa sh.a, zhvillim i cili do të japë impakte gjithnjë e më shumë pozitive në zhvillimin social-ekonomik të vendit.

Miqësisht,
Prof. Asoc. Dr. Bajram Mucaj
Drejtor Ekzekutiv



Message from the Executive Director A/Prof. Dr. Bajram Mucaj

Dear Friends,
Year 2011 was characterized as a tough year for financial institutions. Despite the difficulties caused by the global financial crisis, Fondi Besa j.s.c managed to realize and exceed the planned financial objectives. The joint stock equity reached 833 million ALL. During YR 2011 were disbursed 11,420 loans with a total amount of 3,370,280,529 ALL.

Continuous consolidation and expansion of activities have been one of Besa Fund j.s.c challenges for year 2011. Thus, we employed 83 employees and opened 4 new offices becoming present in more urban and semi urban areas of Albania. As the result of activity expansion, the number of active clients, as end of YR 2011 reached 19,231 with a total loan portfolio of ALL 4,459,452,893 and a PAR of 3.37%.

Based on the achievements and performance, in July 2011, Besa Fund j.s.c. was honored with the special award ARCH OF EUROPE FOR THE QUALITY AND TECHNOLOGY IN GOLD CATEGORY for immeasurable contribution to the business world, for high standing and professionalism demonstrated by prestigious performance.
I want to unequivocally emphasize that the key to Besa Fund j.s.c success has been and remains the transparency, integrity, fairness, open communication and professionalism of our staff at work and excellent cooperation with donors who have supported us in achieving our goals.

As always, Besa Fund j.s.c will play an important role in the financial support of small and medium private entrepreneurship, increasing self-employment, remaining a substantial factor in alleviating poverty in Albania.
Finally, I take this opportunity to thank all contributing staff of Besa Fund j.s.c, as well as all those actors who have contributed and supported the Fund's institutional development, which will provide more and more positive socio-economic impact in the country.

Sincerely,
A/Prof. Dr. Bajram Mucaj
Executive Director

The joint stock equity reached 833 million ALL. During YR 2011 were disbursed 11,420 loans with a total amount of 3,370,280,529 ALL.

The number of active clients as end of YR 2011 reached 19,231 with a total loan portfolio of ALL 4,459,452,893 and a PAR of 3.37%.

Arritjet 2011

Achievements 2011

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	T I/QI 2012	
Kursi Këmbimit US$=Lek	94.14	82.89	87.91	95.81	104	107.5	105.20	*Exchange rate US$ = ALL*
Numri Kumulativ i Kredive	30,344	37,098	45,780	56,042	67,657	78,472	81,833	Cumulative Number of Loans
Shuma Kumulative (million US$)	14.245	194.34	219.99	236.14	251.23	272.07	286.48	Cumulative Amount Disbursed (million US$)

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	T I/QI 2012	
Kursi Këmbimit US$=Lek	94.14	82.89	87.91	95.81	104	107.5	105.20	*Exchange rate US$ = ALL*
Numri i Kredive Aktive	7,291	9,161	11,340	14,909	17,954	19,231	19,927	Active Loan Number
Portofoli i Kredisë (million US$)	29.43	36.96	40.74	42.64	42.12	41.47	43.44	Loan Portfolio (million US$)

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	T I/QI 2012	
Kursi Këmbimit US$=Lek	94.14	82.89	87.91	95.81	104	107.5	105.20	*Exchange rate US$ = ALL*
Nr. i Kredive të Disbursuara në Vit	5,239	6,754	8,689	10,105	11,166	11,420	3,361	No. of Loans Disbursed Annually
Shuma Disbursuar në Vit (million US$)	26.05	32.56	36.76	33.49	31.99	31.34	8.34	Amount Disbursed Annually (million US$)

Kursi i Këmbimit / Exchange rate EURO/Lek më 31.12.2011: 138.93
Kursi i Këmbimit / Exchange rate EURO/Lek më 31.12.2010: 138.77

KREDI AKTIVE NE VITE / ACTIVE LOANS IN YEARS



DISBURSIMET NE VIT /ANNUAL DISBURSEMENTS



AKTIVITETI I KREDISE NE VITE (kumulativ)
LENDING ACTIVITY IN YEARS (cumulative)



Total i aseteve:
Total Assets

5,513 Milion Lekë

Kapitali:
Equity

982 Milion Lekë

Vetëmbajtja Operacionale:
Operational Self Sufficiency

113.40%

Vetëmbajtja Financiare:
Financial Self Sufficiency

107.59%

Raporti Borxh /Kapital :
Debt/Capital Ratio

461.31%

GARANCIA SIPAS OUTSTANDING
GUARANTEE BY OUTSTANDING



KLIENTË AKTIVË SIPAS GJINISË
ACTIVE CLIENTS BY GENDER



PORTOFOLI SIPAS SEKTORËVE
PORTOFOLIO BY SECTORS





Shtrirja gjeografike e Aktivitetit të Fondit Besa sh.a

Fondi Besa sh.a. e zhvillon aktivitetin në 52 zyra, të organizuara në:
- 19 Degë Rajonale
- 33 Zyra satelite,
të cilat mbulojnë praktikisht pjesën më të madhe të territorit Shqiptar me shërbime financiare.
Konkretisht, Fondi Besa sh.a. ndërhyn në:
- 12 Qarqe
- 28 Rrethe
- 39 Bashki
- 39 Qytete

Geographical Extension of Besa Fund j.s.c Activity

Besa Fund j.s.c carries out its activity in 52 offices organized in:
- 19 Regional Branches
- 33 Satellite offices
Actually Besa Fund j.s.c provides financial services in:
- *12 prefectures*
- *28 districts*
- *39 municipalities*
- *39 towns*

BILANCI

BALANCE SHEET

Shifrat në lekë	**31.12.2011**	**31.12.2010**	*Figures in ALL*
AKTIVE			**ASSETS**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	153,272,707	554,792,021	Cash and cash equivalents
Depozita me afat me bankat	921,913,292	679,038,498	Term deposits with banks
Hua për Klientët	4,330,286,977	4,270,379,333	Loans to customers
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	75,508,113	80,997,814	Property and equipment
Investime në aktive të qëndrueshme	21,644,171	18,357,844	Investment property
Tatimi i shtyrë aktiv	-	527,578	Deferred tax asset
Tatim Fitimi i parapaguar	8,563,327	-	Prepaid income tax
Aktive të tjera	1,633,826	1,066,402	Other assets
Totali i Aktiveve	**5,512,822,413**	**5,605,159,490**	**Total assets**
DETYRIMET DHE KAPITALI			**LIABILITIES AND EQUITY**
Hua dhe Kredi	2,585,101,254	2,795,402,867	Loans and borrowings
Borxh i varur	1,802,561,220	1,821,285,566	Subordinated loan
Grante	44,776,714	28,023,588	Grants
Tatim fitimi i pagueshëm	-	27,264,212	Income tax payable
Detyrime të tjera	98,253,637	82,554,692	Other liabilities
Totali i detyrimeve	**4,530,692,825**	**4,754,530,925**	**Total Liabilities**
Kapitali			**Equity**
Kapitali Aksionar	833,092,000	605,261,000	Share capital
Rezerva ligjore	17,536,565	5,540,725	Legal reserve
Fitime të mbartura	131,501,023	239,826,840	Retained earnings
Total Kapital	**982,129,588**	**850,628,565**	**Total Equity**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**5,512,822,413**	**5,605,159,490**	**Total Liabilities and Capital**

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2011 US$/Lek: 107.5
EURO/Lek: 138.93

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2010 US$/Lek: 104.00
EURO/Lek: 138.77

PASQYRA E TË ARDHURAVE

INCOME STATEMENT

Shifrat në lekë	**31.12. 2011**	**31.12. 2010**	*Figures in ALL*
Interesa			**Interest**
Të ardhura nga Interesat	1,151,620,753	1,115,222,429	Interest income
Shpenzime për interesat	(272,179,816)	(289,179,330)	Interest expense
Të ardhura neto nga Interesat	879,440,937	826,043,099	Net interest margin
Të ardhurave jo nga interesi			**Non-interest income**
Të ardhura nga Grantet	10,720,798	6,387,396	Grant income
Të ardhura të tjera, neto	79,491,232	64,279,157	Other income, net
Totali i të ardhura jo nga interesi	90,212,030	70,666,553	Total non-interest income
Shpenzime Operative			**Operating expenses**
Humbja nga zhvlerësimi i kredive për klientët	(194,421,338)	(89,374,881)	Impairment losses on loans to customers
Shpenzime personeli	(385,161,320)	(341,709,146)	Personnel expenses
Shpenzime të tjera administrative	(210,548,213)	(168,043,557)	Other administrative costs
Amortizimi	(31,125,262)	(25,131,151)	Depreciation
Humbjet neto nga lëvizjet në kursin e këmbimit	(1,694,963)	(5,338,008)	Net loss from movements in foreign exchange rates
Totali i Shpenzimeve Operative	(822,951,096)	(629,596,743)	Total operating expenses
Fitimi para tatimit	**146,701,871**	**267,112,909**	**Profit before income tax**
Tatimi mbi fitimin	**(15,200,848)**	**(27,286,069)**	**Income tax expense**
Fitimi neto i periudhës	**131,501,023**	**239,826,840**	**Net profit for the year**
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin që i atribuohet aksionerëve të Shoqërisë	**131,501,023**	**239,826,840**	**Total comprehensive income for the year fully attributable to the equity holders of the Company**

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2011 US$/Lek: 107.5 EURO/Lek: 138.93

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2010 US$/Lek: 104.00 EURO/Lek: 138.77

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

CASH FLOW STATEMENT

Shifrat në lekë	**31.12.2011**	**31.12.2010**	*Figures in ALL*
Flukse të arkës nga aktivitetet operative			**Cash flow from operating activities**
Fitimi neto i periudhës	131,501,023	239,826,840	Net profit for the year
Korrigjime për rakordimin e ndryshimeve të aktiveve neto ndaj mjeteve monetare neto nga aktivitetet operative:			Adjustments to reconcile change in net assets to net cash provided by operating activities:
Amortizimi	31,125,262	25,131,151	Depreciation
Fitime nga pakësimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	(1,614,793)	(255,913)	Gain from disposal of fixed assets
Humbje nga zhvlerësimi i huave për klientët	194,421,338	89,374,881	Impairment losses on loans to customers
Hua të fshira	2,595,401	2,993,074	Loans written off directly
Amortizimi i granteve	(10,720,798)	(6,387,396)	Amortization of grants
Diferenca të kursit të këmbimit nga rivlerësimi i granteve	(149,302)	78,389	Foreign exchange differences on revaluation of grants
Të ardhura nga interesi	(1,151,620,753)	(1,115,222,429)	Interest income
Shpenzime për interesa	272,179,816	289,179,330	Interest expense
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	15,200,848	27,286,069	Income tax expense
Amortizimi i komisioneve të garancisë	(79,501,484)	(81,535,832)	Guarantee fees amortized
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:			**Changes in operating assets and liabilities:**
Rritje në hua për klientët	(264,739,720)	(320,553,317)	Increase in loans to customers
(Rritje)/Ulje në aktive të tjera	(39,846)	1,628,838	Increase/(decrease) in other liabilities
Rritje në detyrime të tjera	15,698,945	16,787,575	Increase in other liabilities
Interesi i arkëtuar	1,132,033,838	1,069,110,842	Interest received
Interesi i paguar	(287,063,928)	(267,553,799)	Interest paid

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2011 US$/Lek: 107.5 EURO/Lek: 138.93

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2010 US$/Lek: 104.00 EURO/Lek: 138.77

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

CASH FLOW STATEMENT

Shifrat në lekë	**31.12.2011**	**31.12.2010**	*Figures in ALL*
Tatimi mbi fitimin i paguar	(51,028,387)	(14,024,393)	Income tax paid
Komisione të garancive të arkëtuara	83,409,152	77,942,010	Guarantee fees received
Flukse të arkës nga aktivitetet operative	**31,686,612**	**33,805,920**	**Cash flows from operating activities**
Flukse të arkës nga aktivitetet investuese			**Cash flows from investing activities**
Rritje në depozita me afat ne banka	(219,380,210)	(621,743,484)	Increase in term deposits with banks
Përvetësimi i aktiveve të qëndrueshme	(8,332,800)	(7,023,552)	Acquisition of investment property
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	(24,877,997)	(30,573,270)	Acquisition of property and equipment
Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	5,903,702	916,303	Proceeds from sale of fixed assets
Flukse të arkës të përdorura në aktivitete investuese	**(246,687,305)**	**(658,424,003)**	**Cash flows used in investing activities**
Flukse të arkës nga aktivitetet financuese			**Cash flows from financing activities**
(Ulje)/Rritje në fonde të marra hua dhe në detyrime të varura	(214,141,847)	1,097,724,388	(Decrease) Increase in borrowed funds and subordinated liabilities
Të ardhura nga grantet	27,623,226	20,004,095	Proceeds from grants
Flukse të arkës (të përdorura) të gjeneruara nga aktivitete financuese	**(186,518,621)**	**1,117,728,483**	**Cash flows (used in)/ from financing activities**
(Zvogëlim)/Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	(401,519,314)	493,110,400	Net (decrease)/increase in cash and cash equivalents
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	554,792,021	61,681,621	Cash and cash equivalents at the beginning of the year
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	**153,272,707**	**554,792,021**	**Cash and cash equivalents at the end of the year**

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2011 US$/Lek: 107.5
EURO/Lek: 138.93

Kursi i Këmbimit / *Exchange rate* 31.12.2010 US$/Lek: 104.00
EURO/Lek: 138.77

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR



KPMG

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
Fondi Besa Sh.A

Tiranë, 27 mars 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Fondi Besa Sh.A ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2011, pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

KPMG

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2011, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

INDIPENDENT AUDITOR'S REPORT



KPMG

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Independent Auditors' Report

To the shareholders of
Fondi Besa Sh.A

Tirana, 27 March 2012

We have audited the accompanying financial statements of Fondi Besa Sh.A ("the Company"), which comprise the statement of financial position as at 31 December 2011, the statements of comprehensive income, changes in equity and cash flows for the year then ended, and notes, comprising a summary of significant accounting policies and other explanatory information.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with International Financial Reporting Standards and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Auditors' Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on our judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, we consider internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting principles used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619061D

KPMG

Opinion

In our opinion, the financial statements give a true and fair view of the financial position of the Company as at 31 December 2011, and of its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Burimet njerëzore

Fondi Besa sh.a. konsideron kapitalin njerëzor një burim strategjik ashtu si çdo aset tjetër të institucionit. Ne besojmë se, në një ekonomi të bazuar në dije, që ndryshon me shpejtësi, avantazhi konkurrues qëndron atje ku individët në mënyrë aktive kërkojnë të fitojnë njohuri dhe aftësi që promovojnë objektivat dhe misionin e organizatës. Zhvillimi i burimeve njerëzore në Fondin Besa sh.a. është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë marrëdhënies mes punonjësit dhe institucionit. Të mësuarit e vazhdueshëm ndihmon punonjësit të rriten sëbashku me rritjen dhe zhvillimin e aktivitetit te institucionit. Kjo është arsyeja pse ne përpiqemi të identifikojmë aftësitë e reja që i duhen punonjësve për të përmbushur objektivat personale dhe të institucionit dhe të organizojmë trajnime që u përgjigjen nevojave të tilla. Të mësuarit gjithashtu rrit aftësinë e stafit që, në mënyrë aktive, të marrë pjesë në përshtatjen e procedurave të punës në përputhje me objektivat e rritjes, sepse punonjësit mund ta shohin mjedisin e punës nga perspektiva të ndryshme.

Human resources

Besa Fund j.s.c considers human capital as strategic a resource as any other asset companies possess. We believe that in a rapidly changing and increasingly knowledge-based economy, the competitive advantage is built where individuals actively seek to acquire the knowledge and skills that promote the organization's objectives and mission. Human resources development in Besa Fund j.s.c is an ongoing process throughout the entire relationship between the employee and the institution. Ongoing learning help employees grow as our business grows. That is the reason why we do our best to identify the new skills that employees need to fulfill personal and corporate objectives and organize training that respond to such needs. Learning can also enhance the ability of staff to actively participate in redesigning work procedures to accommodate growth because employees can see the work environment from various perspectives.

Struktura e Stafit	31.12.2011	Staff Structure
Staf Total	258	Total Staff
Punonjës në zyrë qendrore	48	Head Office staff
Punonjës në degë	210	Branch staff
Drejtorë Rajonalë	17	Regional Director
Asistentë operatorë	17	Assistant operators
Oficerë kredie	175	Credit officers
Femra	104	Female
Meshkuj	154	Male
Staf administrativ/staf bazë	25%75%	Administrative staff/field staff
Zyra	52	Offices

Struktura Organizative
Organization chart



Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2011

Ekonomia shqiptare shënoi norma pozitive të rritjes ekonomike gjatë vitit 2011. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 3.1%. Inflacioni i çmimeve të konsumit u shfaq i luhatshëm gjatë vitit 2011. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 3.5%, duke mbetur në linjë me objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Politika fiskale shfaqi një orientim në rritje drejt konsolidimit. Ky angazhim u reflektua në kontrollin e deficitit buxhetor rreth nivelit 3.5% të PBB-së dhe të borxhit publik rreth nivelit 58.1% të PBB-së. Në përputhje me ecurinë e aktivitetit ekonomik, treguesit e punësimit kanë shfaqur shenja përmirësimi gjatë 2011. Sipas INSTAT-it, numri mesatar i të punësuarve u rrit me 1.7 % , ndërsa norma e papunësisë ka pësuar një reduktim prej 0.2 pikë përqindjeje, duke shënuar vlerën 13.3% në fund të vitit 2011. Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet në ekonominë reale. Kredia për sektorin privat shënoi një rritje mesatare vjetore prej 11.7%, kundrejt vitit 2011. Banka e Shqipërisë ndërmori dy ulje të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit, duke e zbritur normën referencë të interesit në nivelin më të ulët histori të saj, prej 4.75%. Në fund të 2011, aktivet e sistemit bankar përfaqësojnë rreth 85% të PBB-së, nga rreth 81% në fund të vitit 2010. Rezultati financiar i sistemit bankar është ulur, ku përcaktuese ka qenë rritja e madhe e shpenzimeve për provigjone. Fondet rezervë të sistemit bankar janë rritur me rreth 52.4% krahasuar me 2010. Në të kundërt, rezultati neto operacional është rritur me rreth 7.7%, çka tregon se bankat, në përgjithësi, kanë arritur vëllim dhe rezultat neto të qëndrueshëm nga aktivitetet kryesore bankare. Në fund të vitit 2011, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit I sistemit bankar rezulton në rreth 15.6%, më i lartë se ai në vitin 2010 dhe ndjeshëm më i lartë se niveli minimal rregullator prej 12%. Por u evidentua një rritje e treguesit të cilësisë së portofolit të kredisë, "kredi me probleme ndaj totalit të kredisë së sistemit bankar", me rreth 4.8 pikë përqindjeje, duke arritur në 18.8%. Aktiviteti i sektorit jobankar përfaqëson rreth 4.7% të PBBsë së vendit, nga 4.9% që llogaritej në fund të vitit 2010. Në tremujorin e katërt të vitit 2011, aktivet e IFJB-ve rezultuan 34.4 miliardë lekë, rreth 924 milionë lekë (ose 2.77%) më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Peshën kryesore në aktivitetin e IFJB-ve e zë aktiviteti kreditues me një peshë prej 58.3% të totalit të aktiveve. Niveli i kapitalizimit, në tremujorin e fundit të vitit 2011, u ngjit në 36.5%. Raporti hua me probleme ndaj totalit të kredisë për IFJB arriti

në 7.6% në dhjetor 2011, nga 8.1% në qershor 2011 dhe 5.9% në fund të vitit 2010. IFJB kanë shënuar rritje të rezultatit financiar në tremujorin e katërt të vitit 2011, ku fitimi neto rezultoi rreth 1.1 miliardë lekë, nga rreth 978.9 milionë lekë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Për sa i përket nivelit të të ardhurave për të njëjtën periudhë, ato rezultuan 7.1 miliardë lekë, nga 6.7 miliardë lekë që shënonin një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e tyre e dhanë kryesisht të ardhurat nga komisionet, të cilat u ngjitën në nivelin 1.2 miliardë lekë nga 790.3 milionë lekë në fund të vitit 2010.

Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %)

Autoriteti Licensues dhe Mbikqyres	*Sistemi Financiar*	Vitet			
		2006	2007	2008	2009
Banka e Shqiperise	*Sistemi Bankar*	69.6	75.9	76.7	77.5
	Institucione jobanka	1.52	1.48	1.66	2.2
	SHKK dhe Unionet e tyre	0.52	0.63	0.7	0.77
Autoriteti I Mbikqyrjes Financiare	Shoqeri Sigurimi	1.29	1.36	1.45	1.5
	Fondet e Pensionit	-	-	-	0.01

Albanian economy during 2011

Albanian economy recorded positive growth rates during year 2011. INSTAT's data reveal that Albania' s economy grew 3.1% in 2011. Consumer price inflation appeared volatile in 2011. However, the past year's average annual inflation was 3.5%, i.e., in line with Bank of Albania's target. Fiscal policy indicated an upward orientation towards consolidation. This commitment was reflected in maintaining the budget deficit at about 3.5% of GDP and the public debt at about 58.1% of GDP. In line with the economic activity performance, employment figures showed signs of recovery in 2011.

Share of financial system assets to GDP through the years (in %)

2010	2011	Financial system	Licensing and Supervisory Authority
80.9	84.7	Banking System	
2.7	2.6	Non-bank institutions	Bank of Albania
0.78	0.74	SCAs and their Unions	
1.4	1.4	Insurance Companies	Financial Supervision Authority
0.01	0.01	Pension Funds	

According to INSTAT's data, the average number of employed people increased by 1.7%, while the unemployment rate dropped by only 0.2 percentage points to 13.3% at end-2011. Monetary indicators in 2011 were in line with the real economy developments. Private sector credit was up by 11.7% compared to 2010. Bank of Albania carried out two consecutive key interest rate cuts, taking the key interest rate in the economy to the lowest historical level (to 4.75%). At end-2011, the banking system assets accounted for about 85% of GDP, from about 81% at end-2010. Financial profit of the banking system was downward, with a significant increase in provisioning expenses playing a determinant role.

The banking sector increased the provisioning by about 52.4% from a year earlier. By contrast, net operating profit was up by about 7.7%, which shows that the banks have generally achieved a stable net profit and volume from their core activities. As at end-2011, the capital adequacy ratio of the banking system was about 15.6%, being higher than in 2010 and significantly higher than the 12 % minimum regulatory requirement. The loan portfolio quality indicator - non-performing loans to total outstanding loans of the banking system - increased by 4.8 percentage points, settling at 18.8%. Non-banking sector activity represents about 4.7% of GDP of the country, from 4.9% at the end of 2010. In Q4 of 2011, assets of NBFI-s resulted in 34.4 billion, about 924 million (or 2.77%) more than the same period a year ago. Major share in NFBIs activity is lending with a weight of 58.3% of total assets. The level of capitalization, in the last quarter of 2011 went to 36.5%. Loan portfolio quality indicator - non-performing loans to total outstanding loans of the banking system - resulted 7.6% in Dec. 2011, from 8.1% in June 2011 and 5.9% at the end of 2010. NFBI-s have increased the financial results in Q4 of 2011, with a net profit of about ALL 1.1 billion, from about ALL 978.9 million to the same period a year ago. Regarding the income level for the same period, it resulted in ALL 7.1 billion, from ALL 6.7 billion a year ago. The main contribution to growth was given primarily by the income from fees, which went up to level of ALL 1.2 billion from 790.3 million at the end of 2010.

Sfidat
për të ardhmen

- Zgjerimi dhe konsolidimi i vazhdueshëm i aktivitetit huadhënës në mbështetje të biznesit të vogël dhe të mesëm si në zonat ekzistuese ashtu edhe në zona të reja.
- Krijimi i vlerave të vërteta social - ekonomike për klientët. Për t'i mbështetur në mënyrë efektive klientët në përpjekjet e tyre për përmirësimin e nivelit të jetesës, Fondi Besa sh.a aspiron të ofrojë një gamë më të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, të përshtatura për të përmbushur nevojat e klientëve.
- Rritja e standarteve të përgjegjësisë për klientët. Fondi Besa sh.a synon të zhvillojë më tej praktika të përshtatshme për të mbrojtur, shërbyer dhe për të mbështetur klientët dhe për të siguruar një shkallë të lartë transparence në të gjitha nivelet e aktivitetit.
- Ruajtja dhe përmirësimi i treguesve financiarë dhe i vetë-qëndrueshmërisë financiare të institucionit.
- Rritja dhe përmirësimi i efiçencës së stafit nëpërmjet kualifikimit të stafit ekzistues, tërheqjes së njerëzve të rinj dhe motivimit të tyre duke i siguruar se progresi në karrierë është shumë i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e institucionit.

Challenges
for the future

- *Continuous expansion and consolidation of lending activities in support to small and medium business in the existing and new areas.*
- *Creating real social and economic value for clients. Aiming at effectively supporting its clients in their efforts to improve their living standart, Besa Fund aspire to offer a broader array of financial products and services that are tailored to meet client needs.*
- *Raising standards of responsibility to clients. Besa Fund aims at ensuring greater focus on client benefit by further developing sound practices to protect, effectively serve, and support clients and insuring at the same time a high-level transparency in all the business levels.*
- *Maintenance and improvement of financial indicators and institutional self-sustainability.*
- *Improvement of staff efficiency through the qualification of existing staff, attracting new qualified employees, motivating them and ensuring that they progress in their careers are fundamental to the sustainability of our institution.*

FONDI BESA sh.a

fitues:

BESA FUND j.s.c

winner of :

ÇMIMI I ARTE "HARKU I EVROPES" për Cilësinë dhe Teknologjinë

ARCH OF EUROPE AWARD for Quality and Technology in Gold Category

ÇMIMI PLATINIUM për Planifikimin Strategjik, Kënaqësinë Konsumatore, Lidership, Standartizim

PLATINIUM AWARD for Strategic Planning, Customer Satisfaction, Leadership and Standardization.

DEKORUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKES ME MEDALJEN E MIRENJOHJES "Për kontribut në zbutjen e varfërisë, në nxitjen e vetëpunësimit dhe të punësimit, nëpërmjet kreditimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri"

DECORATED BY THE PRESIDENT OF REPUBLIC WITH THE MEDAL OF GRATITUDE "For contributing in poverty reduction, promotion of self-employment and employment, through financing the small and medium enterprises in Albania."

MYDIN DALIPI - Korçë

Me kredinë e parë nga Fondi Besa sh.a prej 1,000,000 lekësh fillova aktivitetin tim bar-bufe. Bleva disa nga pajisjet e domosdoshme dhe nisa punën. Më pas, duke parë se klientela po rritej, mora edhe kredinë e dytë me po të njëjtën vlerë për të zgjeruar aktivitetin. Këtu nuk jam punësuar vetëm unë, por edhe pjestarë të familjes.

With the first loan of ALL 1,000,000 that I received from Besa Fund I started my activity – a small cafe. I bought some of the necessary equipment and started work. Then, seeing that my business was growing, I took a second loan with the same value to expand the activity. Now, not only myself, but also family members are employed in the business.

ILIRJAN TASELLARI – Pogradec

Bashkë me vëllain kam punuar disa vjet në Itali si emigrant, në restorante të ndryshëm. Pas disa vjetësh pune atje, menduam të ktheheshim dhe me një pjesë të kursimeve tona dhe kredinë e parë prej 1,000,000 lekësh të hapnim një bar-restorant-piceri, në një zonë shumë të bukur dhe të frekuentuar në Drilon, Pogradec. Menduan të investonin në një aktivitet të ngjashëm me eksperiencën që fituam, sepse atë dinim të bënim më mirë. Pasi e ndjemë se aktiviteti po zhvillohej dhe frekuentushmëria ishte e lartë, vendosëm të marrim një kredi të dytë prej 3,000,000 lekësh për investime të reja në biznes.

Together with my brother I have worked in Italy as an immigrant in different restaurants. After several years working there, we thought to come back and open a bar-restaurant-pizzeria, in a very beautiful area, in Drilon, Pogradec. We invested in this business a part of our savings and received also our first loan from Besa Fund to the amount of ALL 1,000,000. We thought to invest in an activity similar to the experience that we gained in Italy. Once we felt that the activity was going on well and we had enough clients, we decided to take a second loan of ALL 3,000,000 for new investments in our business.

BESNIK BICA – Elbasan

Nuk e kisha të lehtë të filloja biznesit e duraluminit vetëm me ato pak kursime të familjes. Pak kohë pasi fillova punën, doli e domosdoshme të bleja lëndë të parë për të përballuar kërkesën. Mora kredinë e parë nga Fondi Besa sh.a dhe më pas kredinë e dytë dhe të tretë nga Fondi Besa sh.a përkatësisht në shumat 200,000 lekë, 300,000 lekë dhe 500,000 lekë, që më kanë ndihmuar të blej jo vetëm lëndë të parë, por edhe makineri të reja dhe moderne.

It was not easy for me to start the business of making aluminum doors and window frames only with the few household savings I had. Shortly after I started work, I found it necessary to buy raw material to have the possibility to continue working and satisfy the demand. I took the first loan from Besa Fund and then the second and third one, respectively in the amounts of ALL 200.000, ALL 300.000 and ALL 500.000, which have helped me not only buy raw materials, but also new and modern machineries.

Partnerët

Fondi Besa sh.a. ka përvojë të gjatë bashkëpunimi me partnerë strategjikë me të cilët ndajmë të njëjtin vizion për zhvillimet aktuale dhe të ardhshme. Ne vlerësojmë të gjithë partnerët tanë dhe falë marrëdhënieve afat-gjatë me ta, kemi një ndikim të matshëm në përmbushjen e nevojave financiare të klientëve, duke krijuar mundësi punësimi, biznese të qëndrueshme dhe rritjen e konkurrencës në treg.

Partners

Besa Fund j.s.c has many years of experience in cooperating with strategic partners and with whom we share the same vision for the present and future developments. We value all our partners and thanks to the long- term relationships with them, we are driving measurable impact by fulfilling our clients' financial needs, creating employment opportunities, building sustainable businesses and increasing marketplace competitiveness.

CoopEst
finance for social economy | initiatives in central eastern europe

responsAbility
leading social investments

ABC ALBANIAN BESA CAPITAL
Fondacioni ABC

Raiffeisen BANK

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

SOCIETE GENERALE ALBANIA

TIRANA BANK

fondiBESA

2011

RAPORT VJETOR
ANNUAL REPORT

Rruga "Brigada VIII", Pallati No. 5
Tirana, Albania
Tel: 04 22 53 841
Tel: 04 22 53 842
Tel: 04 22 52 913
Tax: 04 22 53 836
E-mail: mfi@besa.org.al
www.fondibesa.com